



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr.02/1555 25/10/2017

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/L-037, si dhe nenit 48, paragrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit "Kadri Zeka" shpall

K O N K U R S

Për zgjedhjen apo rizgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan

FAKULTETI I EDUKIMIT

1. Një asistent për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II-Fillor dhe Parafillor, Gjuhë Angleze I dhe II- Juridik dhe Gjuhë angleze I dhe II në BFK, Marketing dhe Menaxhment.
2. Një asistent për lëndët: Filozofi e edukimit, Metodologji e edukimit gjithëpërfshirës, Strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme, Zhvillimi i kurrikulave, Komunikimi në edukim, Puna me fëmijët e talentuar dhe Bazat e hulumtimit në edukim në programin parashkollor; Filozofi e edukimit, Teori e mësimin, Orientim profesional, Komunikimi në edukim dhe Bazat e hulumtimit në edukim, në programin fillor.

FAKULTETI EKONOMIK

1. Dy asistentë për grup lëndësh nga: Banka, Financa dhe Kontabilitet;
2. Një asistent për grup lëndësh nga: Ekonomiks-i.

FAKULTETI JURIDIK

1. Një asistent për grup lëndësh nga: E drejta penale;
2. Një asistent për grup lëndësh nga: E drejta civile;
3. Një asistent për grup lëndësh nga: E drejta Kushtetuese - Administrative;

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. Një mësimdhënës në thirrjen profesor i asocuar, për lëndët: Programim I, Programim II, Programi i Orientuar në Objekte, Algoritmet dhe struktura e të dhënave;
2. Një asistent për lëndët: Qarqet digjitale, Arkitektura e kompjuterëve & SO, Zhvillimi i Web aplikacioneve, Inxhinieri Softuerike, TIK në edukimin fillor, Rrjetat Kompjuterike, Web Teknologjitë, Rrjetat dhe cloud, Dizajnimi Multimedia, TIK ne edukimin parafillor.

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoraturës, të noterizuara
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës)
- Dëshmi për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.;
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies;
- Dëshmi se ndaj tij nuk zhvillohen hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet bachelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Statutin e Përkohshëm të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan, në veçanti ato që parashihen në nenin 156,157, 159 të këtij Statuti (shih: <http://uni-gjilan.net/dokumente-relevante/>)

Konkursi mbetet i hapur nga data 25.10.2017 deri më 08.11.2017.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Zyrën nr.3.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>